

### **Ekonomi takon ambasadorin ukrainas**



Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Milva Ekonomi u takua me ambasadorin e Ukrainës në Shqipëri, Volodymyr Shkurov, i cili ka nisur detyrën në krye të shërbimit diplomatik ukrainas në Tiranë prej tetorit të vitit 2020. Ministrja e MBZHR Milva Ekonomi u shpreh e gatshme për nënshkrimin e një Memorandimi Mirëkuptimi në fushën e bujqësisë ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë për Zhvillimin Ekonomik, Tregtisë dhe Bujqësisë të Qeverisë së Ukrainës .

### **Zhvillimi i blegtorisë**

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Milva Ekonomi ishte e ftuar në konferencën online me fokus zhvillimin e sektorit të blegtorisë që u organizua nga fondacioni "Blegtorja dhe Bujqësia shqiptar". Në fjalën e saj, ministrja Ekonomi falenderoi organizatorin e konferencës Gojart Smaja me të cilën është vendosur një bashkëpunim i mirë sa i takon shkëmbimit të mendimeve dhe sugjerimeve që ai përcjell në drejtim të MBZHR. Ekonomi vlerësoi organizimin e kësaj konference e cila përkon dhe me momentin kur MBZHR do të çelë aplikimet për Skemën Kombëtare mbështetëse, ku blegtorët janë ndër përfituesit e saj.



### **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin**



Në komision për të paraqitur Marreveshjen ndryshuese të Bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në lidhje me lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit .

### **Vijon shpërndarja e kartave të naftës në qarkun e Durrësit**



Vijon shpërndarja e kartave të naftës në qarkun e Durrësit, për fermerët e regjistruar me NIPT, të shpallur fitues të skemës së mbështetjes me naftë falas që ka nisur të aplikohet prej datës 15 janar të këtij viti. Krahas procesit të aplikimit online në portalin e-albania, fermerët që kanë aplikuar më herët dhe që janë shpallur fitues të skemës, mund të tërheqin kartën e naftës falas në zyrën e AREB Durrës.

### **Vizitë zyrën në zyrë AREB në qytetin e Korçës**

Ministrja Ekonomi ,bashkë me Ministrin e Mbrojtjes dhe njëkohësisht deputetin e qarkut Korçë, vizitoi zyrën e Agjencisë së Ekstensionit Bujqësor në qytetin e Korçës, ku aplikues të suksesshëm të Skemës së Naftës tërheqin kartat me sasinë e naftës falas. Në AREB fermerët informoheshin edhe për hapjen e thirrjes për Skemën Kombëtare të Mbështetjes 2021 për fermerët dhe blegtorët shqiptarë, duke aplikuar në e-Albania, që nga data 24 Mars.



### **Vizitë në "Pularia Tirana"**



Gjatë vizitës në ambientet e kompanisë "Pularia Tirana", prej 4 vitesh aktive në tregun shqiptar me produktet e saj, Ministrja Ekonomi pa nga afër investimet e kryera që kanë mundur rritjen e aktivitetit nga viti në vit. Kompania realizon sot rritjen e 300 mijë zogjve për prodhim mishi në vit. Veterineri i kësaj kompanie më konfirmoi se zogjtë i nënshtrohen skemës së vaksinimit që ofrohet nga Ministria e Bujqësisë, duke garantuar në këtë mënyrë produkte cilësore për konsumatorin shqiptar.

### **Vizitë në fabrikën e miellit "Miell Tirana"**



Në një nga prodhuesit më të mëdhenj të miellit "Miell Tirana", Ministrja Ekonomi pati mundësinë të shikojë nga afër zhvillimet e sektorit të drithrave në vendin tonë. Nëpërmjet një teknologjie moderne, laboratorëve dhe kontrolleve periodike, bëhet një punë e shumë e mirë në fabrikën e tyre, për të garantuar produkte cilësore dhe rritur sigurinë ushqimore për konsumatorin shqiptar. Ky vetëkontroll lehtësonte edhe bashkëpunimin me agjencitë e specializuara të kontrollit - AKU, ku kontrollet e cilësisë siguronin qëndrueshmërinë e parametrevë të miellit dhe prodhimeve të përfituar prej tij.

### **Vizitë në fermën blegtorale Zekolli**

Gjatë vizitës në Korçë Ministrja Ekonomi vizitoi fermën e re të Meleqit ku mbarështohen 16 krahë lopë të rracës Holstein të importuara nga Gjermania, i cili tregoi se pasioni për punën e blegtorit ishte shtyssa e kësaj nisme në të cilën janë përfshirë të gjithë anëtarët e familjes së tij. Në këtë sipërmarrje të re, ai është asistuar nga shërbimi veterinar dhe e informova mbi Skemën Kombëtare të Mbështetjes 2021 për fermerët dhe blegtorët shqiptarë. Aplikimi bëhet në e-Albania, duke nisur nga data 24 Mars.



Kemi ardhur për të bërë një vizitë në fermën e sapo ndërtuar të z. Meleq. Ai ka marrë disa lopë nga Gjermania të rracës Holstein

### **Vizitë në kompaninë "Cocoal" shpk**



Vizitë në kompaninë "Cocoal shpk" Maminas, për të parë një investim serioz që ka marrë mbështetjen edhe nga Skemat Mbështetëse Kombëtare në Bujqësi duke zhvilluar një pulari sipas standarteve dhe me një teknologji bashkëhore. Për vitin 2021 aplikimi në Skemat Kombëtare nis me datën 24 Mars.